VENDIM
Nr. 218, datë 17.4.2019

PËR TRANSFERIMIN, NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË, TË NJËSISË ADMINISTRATIVE TIRANË, TË PASURISË ME NR. 3/20, ME VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 8340

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin, në pronësi të Bashkisë Tiranë, të njësisë administrative Tiranë, të pasurisë me nr. 3/20, me vendndodhje në zonën kadastrale 8340, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi, për t'u përdorur në fushën e arsimit.
2. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës përfundimtare të pjesshme të pronave të paluajtshme publike shtetërore, miratuar me vendimin nr. 219, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pjesshme (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të njësisë administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, të Qarkut të Tiranës", të ndryshuar.
3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës (Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

31	8340 H,I-12	3/20		Truall Rruga "5 maj"		17509		Bashkia	Bashkia	shtet, vol. 16, fq 205 Projekt per shkolle te re Sheshi 8/1, NjA nr.8 Miratuar me VKT nr. 3/19,dt 9.2.2017